



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 19.2.2020

Lënda: Parashtrime të Komisionerit Publik, në seancën gjyqësore të datës 19.2.2020, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 86, datë 17.12.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Alma Kolgjoka

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me anë të vendimit nr. 86, datë 17.12.2018, ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka, aktualisht gjyqtare/Kryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

Në zbatim të nenit 55, pika 7 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë (IKP), më datë 18.1.2019, është njoftuar vendimi nr. 86, datë 17.12.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Alma Kolgjoka.

Komisioneri Publik, pas analizës tërësore të provave dhe akteve të administruara nga hetimi administrativ i Komisionit, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 63, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, brenda afatit 15-ditor nga njoftimi i vendimit, ka ushtruar ankim.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka, ushtron detyrën e gjyqtarit dhe të Kryetarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe, në bazë të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, i është nënshtuar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Procesi i rivlerësimit për znj. Alma Kolgjoka ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kritereve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Nisur nga rezultatet e hetimit për secilin kriter dhe nga provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit, znj. Kolgjoka, ka plotësuar së bashku kushtet e parashikuara nga neni 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe ka vendosur: *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka, me funksion gjyqtare dhe Kryetare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë*. Ndaj këtij vendimi është ushtruar ankimi nga Komisioneri Publik.

Duke u qëndruar shkaqeve të parashtruara në ankimin e Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 86, datë 17.12.2018, parashtrojmë si vijon:

II. Vlerësimi i Komisionerit Publik

3. Nga aktet në dosje rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Kolgjoka, në deklaratën “Vetting” ka deklaruar pasuritë si vijon: (1) Automjet me targë AA ***, në pronësi të bashkëshortit, me vlerë 3.999 euro; (2) Pasuri e paluajtshme e llojit “Shtëpi banimi”, me vendndodhje në rrugën “***.***”, Tiranë, në proces legalizimi, krijuar nga familja e bashkëshortit para lidhjes në martesë, me burim kursimet e familjes së bashkëshortit; (3) Kursime në *cash* në vlerën 200.000 lekë (dyqind mijë); (4) Llogari bankare pranë *** Bank, në vlerën 2.100.000 lekë (dy milionë e njëqind mijë).

4. Subjekti i rivlerësimit, znj. Kolgjoka, në përgjigjet e pyetësorit, të datës 1.3.2018, lidhur me vendbanimet ku ka jetuar gjatë periudhës 2011 - 2017, ndër të tjera, ka deklaruar si një nga vendbanimet e saj, shtëpinë e prindërve në adresën: Rruga “***.***”, Tiranë.

5. Komisioni, lidhur me këtë pasuri të deklaruar si vendbanim nga subjekti i rivlerësimit, ka arsyetuar se: “... nga gjendja e akteve në dosje, trupi gjykues konstatoi se babai i subjektit, me anë të kontratës së shitblerjes me rezervë ligjore, ka blerë një apartament me sipërfaqe 141.87 m², në vitin 2012. Trupi gjykues, edhe në këtë drejtim, verifikoi rrethanat nëse subjekti mund të vishej me ndonjë kualifikim të mundshëm si “person i lidhur” apo “personit tjetër i lidhur”, në kuptim të nenit 3, pika 14 dhe nenit 32, pika 4 të ligjit nr. 84/2016. Në këtë drejtim, trupi gjykues konstatoi rrethanat se subjekti i rivlerësimit ka lidhur martesë në vitin 2011 dhe ka dalë me certifikatë më vete me familjen e saj të re, dhe në kuptim të ligjit nr. 84/2016, në periudhën që babai i saj ka blerë apartamentin (viti 2012), nuk e kualifikon atë si “person të lidhur” apo “personit tjetër të lidhur”, në mënyrë që të bëhej vlerësimi i burimeve të ligjshme për këtë pasuri. Trupi gjykues arrin në këtë konkluzion edhe për sa kohë nga hetimi administrativ nuk i rezultoi ndonjë rrethanë tjetër ligjore, që mund të lidhte subjektin e rivlerësimit me ndonjë kontribut/shpenzim të mundshëm të saj mbi këtë pasuri”.¹

6. Për efekt të këtij gjykimi, Komisioneri Publik kërkon hetim të mëtejshëm për sa i përket pasurisë së paluajtshme, apartament me sipërfaqe 141,87 m², ndodhur në rrugën “***.***”, Tiranë, për të kuptuar dhe kufijtë ligjorë të ushtrimit të një ankimi në një rast të ngjashëm në të ardhmen, pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

7. Lidhur me pasurinë apartament me sipërfaqe 141,87 m², ndodhur në rrugën “***.***”, Tiranë, për të cilin subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nga muaji shtator 2017 e në vijim, në

¹ Faqe 11 e vendimit

*ditë të ndryshme, qëndron në të, në dosje të Komisionit, ndër të tjera, është administruar Kontratë shitblerje me rezervë nr. *** rep., nr. *** kol, datë ***.7.2012, lidhur midis Shoqërisë “***” sh.p.k., në cilësinë e shitësit dhe z.***.*** (i ati subjektit të rivlerësimit), në cilësinë e blerësit. Objekt i kësaj kontrate është premtim shitje apartamenti me sipërfaqe totale ndërtimi 141,87 m². Çmimi i kontratës është **11.065.860 lekë** (njëmbëdhjetë milionë e gjashtëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë).*

8. Nga aktet e administruara në dosjen e Komisionit rezulton se në emër të z.***.*** figuron 1 (një) pasuri aktive, apartament me sipërfaqe 78.9 m² me adresë: ruga “***.***”, pallati *** Tiranë, blerë në vitin 2006, në vlerën 1.500.000 lekë, dhe apartamenti me sipërfaqe 141,87 m² ndodhur në rrugën “***.***”, Tiranë, blerë në vitin 2012, në vlerën 11.065.860 lekë, ky i fundit i pa konfirmuar nga ZVRPP-ja Tiranë.

8.1 Komisioneri Publik, nga aktet në dosje, vëren se familjarët e subjektit të rivlerësimit duket se nuk kanë pasur mundësi financiare me të ardhura të ligjshme për blerjen e pasurisë apartament me sipërfaqe 141,87 m², blerë në vitin 2012, në vlerën 11.065.860 lekë.

8.2 Sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se Komisioni duhet ta kishte cilësuar si *person tjetër të lidhur z.***.****, dhe do të duhej të verifikonte edhe përmbushjen e detyrimit ligjor të justifikimit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurisë apartament me sipërfaqe 141,87 m² me vendndodhje në Tiranë. Komisioneri Publik kërkon nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit një vendimmarrje rreth kësaj çështje, e cila do të përcaktojë dhe qëndrimin e Komisionerit Publik në vazhdimësinë e këtij gjykimi.

III. Kërkimi i ankimit

9. Mbështetur në parashikimin e nenit F, pikat 3 dhe 7 të aneksit të Kushtetutës, nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, kërkohet që shkaqet e parashtruara në këtë ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, duke e cilësuar si *person tjetër të lidhur z.***.****, në zbatim të nenit 3, pika 14, të ligjit nr. 84/2016, dhe të hetohet në drejtim të burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë apartament me sipërfaqe 141,87 m² ndodhur në rrugën “***.***”, Tiranë.

10. Sa më sipër, pas hetimit të plotë të kriterit të kontrollit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka, Kolegji, në përfundim të gjyqimit të çështjes, të vendosë:

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 86, datë 17.12.2018 ose
- Ndryshimin e vendimit nr. 86, datë 17.12.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka.

KOMISIONERI PUBLIK

DARJEL SINA